Kronikë

# Mbi 1300 rrënjë kanabis në pyll, miliona lekë, armë dhe mjete të sekuestruara, megaoperacion në Krujë, 5 persona në pranga, 2 në kërkim (VIDEO)

*Policia e Krujës ka finalizuar me sukses një operacion disamujor të koduar "Survey", bilanci i të cilit janë 5.3 kg kanabis gati për t'u nxjerrë në treg, mbi 1300 rrënjë kanabisi të asgjësuara, para dhe të mira materiale, si dhe ka vënë në pranga 5 persona.*

Redaksia
8 Tetor, 11:12 | **Përditesimi: 8 Tetor, 11:21**

Policia e Krujës ka bërë të mundur arrestimin e 5 personave ndërsa 2 të tjerë janë shpallur në kërkim, në kuadër të megaoperacionit të koduar "Survey".

Gjatë periudhës së hetimit janë sekuestruar në total 1353 rrënjë kanabisi që ishin mbjellë në zona të pyllëzuara në Malësinë e Krujës. Janë sekuestruar gjithashtu 2 450 000 lekë, 4000 euro, 9 aparate celulare, 4 automjete dhe 1 armë gjahu.



LEXO EDHE:
**Megaoperacion antidroge në Itali, Holandë e Belgjikë, në pranga 38 trafikantë, mes tyre edhe shqiptarë! U sekuestrohen kokainë dhe një shumë parash**

Në prangat e policisë janë vënë shtetasit -Artan Elezaj 35 vjeç, Afmet Elezaj 41 vjeç ( vëllezër), Sokol Xaka 24 vjeç, Gezim Lloti 36 vjeç dhe Perparim Kasa 47 vjeç. Gjithashtu, u shpallën në kërkim shtetasit Muharrem Xaka 26 vjeç (vëllai i shtetasit të arrestuar Sokol Xaka) dhe Bilal Afmeti, 37 vjeç.

> *"Krujë / Finalizohet pas një hetimi disamujor, megaoperacioni policor antikanabis i koduar "Survey".*
>
> *Si rezultat i finalizimit të këtij megaoperacioni sekuestrohen 5.3 kg kanabis të gatshme për shitje, si dhe janë evidentuar e asgjësuar gjatë periudhës hetimore, 1353 bimë kanabisi, të kultivuara në zona të pyllëzuara.*
>
> *Vihen në pranga 5 shtetas për këtë veprimtari kriminale, si dhe shpallen në kërkim 2 bashkëpunëtorët e tyre.*
>
> *Sekuestrohen gjithashtu, 2 450 000 lekë, 4000 euro, 9 aparate celulare, 4 automjete dhe 1 armë gjahu.*
>
> *Shërbimet e Komisariatit të Policisë Krujë, si rezultat i kontrolleve të pandërprera të territorit, për evidentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike në zona të pyllëzuara, si dhe pas një pune të mirëfilltë hetimore disamujore, në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjuqësor Krujë, kanë organizuar dhe finalizuar megaoperacioni policor antikanabis të koduar "Survey", si rezultat i të cilit u vunë në pranga shtetasit:*
>
> *-A. E., 35 vjeç, A. E., 41 vjeç ( vëllezër), S. X., 24 vjeç, G. Ll., 36 vjeç dhe P. K., 47 vjeç.*
>
> *Gjithashtu, u shpallën në kërkim shtetasit M. X., 26 vjeç (vëllai i shtetasit të arrestuar S. X.) dhe B. A., 37 vjeç.*
>
> *Nga hetimet rezultoi se këta shtetas, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë kultivuar në kohë dhe në ambiente të hapura të ndryshme, 1353 bimë narkotike, në zona të pyllëzuara të fshatit Bruz Mal, të cilat janë evidentuar dhe asgjësuar përgjatë periudhës hetimore. Në vijim të kontrolleve në kuadër të operacionit "Survey", në banesën e shtetasit të arrestuar G. Ll., u gjetën dhe u sekuestruan 5.3 kg lëndë e dyshuar narkotike kanabis e gatshme për shitje. Gjithashtu, u sekuestruan në cilësinë e provës materiale 2 450 000 lekë, 4000 euro, 9 aparate celulare, 4 automjete dhe 1 armë gjahu, të dyshuara të përfituara apo të përdorura për kryerjen e kësaj veprimtarie kriminale.*
>
> *Vijon puna për kapjen e shtetasve M. X. dhe B. A.*
>
> *Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për veprime të mëtejshme", thuhet në njoftim.*

K.T./r.k./Shqiptarja.com

TAG: Arrestime arme kanabis droge krujë Durres

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**Çmimi i hidrokarbureve, a po i mbron Bordi interesat e qytetarëve?**

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera

Kronikë

Përfshihet nga flakët një banesë në Fushë-Krujë, digjet dhoma e katit të dytë (VIDEO)
28 Shtator, 19:30

Kronikë

Mbytet peshkarexha në Durrës, ishte ankoruar për shkak të motit të keq! Do restaurohej në portin e vjetër
27 Shtator, 13:24

Politikë

Bilanci i sezonit turistik, Rama: Kontribut deri në 17% në ekonomi, më parë ishte vetëm 4%! Ministrja: 30% e plazheve do jenë publike në vitin 2023
27 Shtator, 11:27

Kronikë

E fshehur në një bidon vaji për makina, zbulohet pistoleta në disa bagazhe në Portin e Durrësit! Prangoset poseduesi
27 Shtator, 10:19

Kronikë

U arrestua në Kolumbi, 'Gucci' shqiptar dyshohet se ka gisht në zhdukjen e këngëtarit nga Elbasani! Çfarë zbuloi 'Pa Gjurmë' dhe rrëfimi i nënës
27 Shtator, 09:24

Kultura

Do i nënshtrohet rinovimit, mbyllet nesër Muzeu Arkeologjik i Durrësit! Hapet në tetor 2023
26 Shtator, 17:08

Politikë

Integrimi, ambasadorja Hohman në Durrës: Kjo fazë nuk është e lehtë, por BE do qëndrojë krah jush deri në fund të procesit
26 Shtator, 14:46









© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje